

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR.-427- akti

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES“

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbëre nga:

Gjyqtar- ARTAN GJERMËNI,

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Valtida Ribaj**, sot më datë **11.03.2013** me prezencën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Kol Hysenaj** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me nr. **427** Akti, që i përket:

KERKUES:

Y.S i biri i (.....), datl.(....), lindur ne(.....) dhe banues ne Turqi, me adrese(.....) ,ne mungese, perfaqesuar me prokure te pergjithshme nr.3870 rep, 1050/3 Kol, date 12.12.2012 ,nga av. Ylli Kameri, Dhoma e Avokatisë Tirane ,me nr.1393 license dhe nipt K72229019 V.

OBJEKTI :

Konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit te sekuestros konservative te dates 08.12.2012 kartmonedha shtetasit Y.S, nga Oficeri i Policise Gjyqesore Rinas.

BAZA LIGJORE :

Neni 110,112,28 germa b,130/4,neni 301/2 te K.Pr.Penale

Ne konkluzionet përfundimtare :

- Avokati kërkoi : Pranimin e kerkeses.

-Prokurori kërkoi : -Rrezimin e kerkeses

Gjykata pasi dëgjoji konkluzionet përfundimtare, deklaroi te mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe si cmoi provat ne tërësi

V E R E N :

Ankuesi ka paraqitur ankim e parashtron(sintetike) se:

Mbi bazen e materialit kallezues te Komisiariatit te Policise Kufitare Rinas kane filluar veprimet hetimore ,kunder kerkuesit si i dyshuar per kryerjen e vepres penale te parashashikuar nga neni 179/a K.Penal

Nga aktet rezulton se me dt.8.12.2012 nga ana e oficerit te policise gjyqesore kufitare Rinas ne zbatim te nenit 300/2 K.Pr.Penale, ankuesit Y.S i jane sekuestruar prove materiale gjithsej 30.000.euro.

Nuk rezulton nga aktet qe ne zbatim te nenit 301 te K.Pr.Penale prokurori me vendim te motivuar te jete shprehur per vleftesim(si te ligjshen a te paligjshem) te veprime te bera

nga ana e oficerit te policise ne afatin e percaktuar ne kete dispozite, ne maksimum brenda dates 12.12.2012

Nga ana e kerkuesit eshte paraqitur kerkese prane organit te akuzes dt 04.02.2013 per heqje sekuestro, me argumentet e paraqitura ne te, e kjo e fundit me dt.12.02.2013, ka kthyer pergjigje duke e konsideruar te ligjshem veprimin e bere nga oficeri i policise.

Per sa me siper ne analize të provave që ndodhën në këtë fashikull gjyqesore , perfaqesuesi i ankuesit pranimin e ankimit,e nga ana e

prokurorit u kerkua rrezimi i kerkeses.

Gjykata pasi cmoi ne tërësi provat, ne analize te pretendimeve te paraqitura sipas ankimit respektiv dhe ne raport me dispozitat procedurale penale qe lidhen me kontrollin gjyqësor, mbi veprimtarine e prokurorit konkludon ne mos pranimin e ankimit si te pa bazuar ne ligj.

Konstatohet se ky procedim penal gjendet ne fazen e hetimit e cmuarja e pavlefshmerise, ne zbatim te nenit 131 te K.Pr.Penale behet nga ana e prokurorit.

Edhe tej kufijve te logjikes me siper, perseri gjykata vendos rrezimin e kerkeses edhe me argumentin tjetër se gjykata ne zbatim te nenit 301 K.Pr.Penale, ka te drejte te gjykoj vendimin e prokurorit qe ka vleftesuar sekuestron qe kundershohet, e jo veprimin e oficerit te policise gjyqesore, e nga aktet nuk rezulton se ka nje vendim te tille. Mendohet qe pala nuk ka si ta detyroje prokurorin qe te vleftesoje aktin e sekuestros, e ajo ka te drejte per nje proces ligjore te kundershohje ne gjykate veprimet e oficerit te policise gjyqesore ,por perseri konstatohet ne ceshtjen objekt gjykimi se (ankimi),kundershtimi eshte jashte afatit 10 ditor percaktuar nga neni 301 K.Pr.Penale.

PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar ne neneve 131,300,301 K.Pr.Penale gjykata

V E N D O S I :

1. Rrezimin e kërkesës.
 2. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kërkuarit.
 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë sipas ligjit.
- **U shpall sot ne Tirane me date 11.03.2013.**

Sekretare
Valtida Ribaj

Gjyqtar
Artan Gjermani